



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 6874 Prot

Shkodër, më 17.5.2023



ANIMALS NEED ME

Nr. 1 Prot

Shkodër, më 17.5.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/___, ndërmjet palëve si më poshtë:

Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr 1, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër **Z. Bardh Spahia**, përfaqësuar me Vendimin nr. 93 date 13.04.2023 "Për delegim kompetence" nga Zv/Kryetari **Z. Tonin Dedaj**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**:

dhe

Shoqata "ANIMALS NEED ME", dhe me nr NIPT-i **L97308131R** themeluar në vitin 2019 sipas vendimit të gjykatës nr 6262 datë 31 maj 2019, me adresë: Rruga Vaso Kadia, Pallati 260, Shkodër, përfaqësuar nga **z. Flamant Hoxha**, sipas kartës së identitetit me nr. I10405212E, këtej e tutje cilësuar si **Shoqata**:

Duke marrë në konsideratë se:

Shoqata "Animals Need Me" është një organizatë vullnetare e cila e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2012, duke u fokusuar në ndihmën ndaj qenve dhe maceve endacakë në qytetin e Shkodrës, Shqipëri.

Qëllimi i kësaj shoqate është :

1. Rritja e ndërgjegjësimit mbi çështjen e kafshëve endacake në shkolla dhe në media.
2. Fushata masive për sterilizimin e tyre.
3. Dhënie e ndihmës mjekësore për qentë dhe macet endacake të sëmurë ose të plagosur.
4. Sigurimi i strehimit për ato kafshë që nuk mund të mbijetojnë në rrugë.
5. Gjetja e familjeve adoptuese, në nivel lokal dhe ndërkombëtar, për qentë dhe macet që ushqejnë.

BAZA LIGJORE

- Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar
- Ligjin Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- VKM nr. 475, datë 30.7.2021 “Për bashkëpunimin e njërive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”

NENI 1

Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është përkujdesja dhe strehimi afatgjatë i qenve të pastrehë të qytetit të Shkodrës.

NENI 2

Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka si qëllim rregullimin e marrëdhënieve midis Bashkisë Shkodër dhe shoqatës “ANIMALS NEED ME” për grumbullimin dhe mbrojtjen e qenve endacakë tek strehëzat e ndërtuara nga Bashkia Shkodër, me vendodhje në fshatin Rrenc, Njësia Administrative Guri i Zi, bashkia Shkodër, duke u siguruar atyre përkujdesjen, sterilizimin, vaksinimin, strehimin si dhe kushtet optimale për të jetuar.

NENI 3

Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet me afat 2 (dy) vjeçar me të drejtë rinovimi, duke filluar që nga momenti i nënshkrimit të saj.

NENI 4

Rolet dhe detyrat e shoqatës “ANIMALS NEED ME”

Shoqata “ANIMALS NEED ME” merr përsipër:

- Mirëmbajtjen e këndit/ambientit ambulator me të gjithë shërbimin mjekësor.
- Heqjen nga rruga dhe strehimin e shumicës së qenve me probleme të dukshme shëndetësore (probleme të rënda lëkure, qen të aksidentuar, qen të verbër).
- Prishjen e tufave dhe strehimin e 1-2 qenve problematikë ndër lagjet e qytetit
- Mjekimin e rasteve me probleme shëndetësore.
- Adoptimin e qenve të strehuar, brenda dhe jashtë vendit me ndihmën e partnerëve si Pro Qen Albania. (Adoptimi liron hapësirë në strehë për mesatarisht 80-100 qen të rinj në vit.)
- Eliminimin nëpërmjet eutanazisë të qenve të sëmurë terminalë dhe pa perspektivë shërimi sipas ligjit të veterinarisë në fuqi.
- Edukimin e popullsisë mbi fenomenin dhe trajtimin e kafshëve endacake, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

- Realizimin e aktiviteteve me shkolla dhe qendra komunitare, në bashkepunim me bashkinë Shkoder.
- Promovon pronësinë e përgjegjshme.
- Ndhomon në mbajten e të dhënave të Rregjistrit të qenve të bashkisë Shkodër sipas modelit të hartuar nga SPV.
- Bashkëpunon me institucione, universitete, fondacione, organizata dhe klinika në projekte që synojnë rritjen e mirëqënies së kafshëve të qytetit të Shkodrës.
- Strehimin e qenve bazuar në standartet e miratuara.
- Përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, nëpërmjet mirëmbajtjes, investimeve etj me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për pritjen e vizitorëve vendas dhe të huaj.
- Për çdo investimin apo ndërhyrje shoqata duhet të marrë më parë miratimin me shkrim në strukturat përgjegjëse në bashkinë Shkodër.
- Pastrim ditor dhe ruajtjen e higjienës, ushqyerjen në bashkëpunim me Bashkinë Shkoder.
- Trajnimin e punonjësve të angazhuar nga bashkia për ofrimin e një shërbimi të mirë për mirëqenien e kafshëve në strehim.
- Raportimin te Bashkia Shkodër të çdo problematike lidhur me performancën e punonjësve të pastrimit, ushqimit dhe rojes të punësuar nga bashkia.
- Afrimin e vullnetarëve dhe veterinerëve të rinj në çdo rast me miratimin e bashkisë Shkodër.
- Raportimin mujor në strukturën përgjegjëse të bashkisë Shkodër, në lidhje me aktivitetin e realizuar.
- Raportimin vjetor të veprimtarisë së strehës, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

NENI 5

Rolet dhe detyrat e Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër merr përsipër:

- Vendosjen në dispozicion të shoqatës të sipërfaqes së strehzës e projektuar dhe e ndërtuar nga bashkia Shkodër në kuadrin e realizimit të qëllimit të marrëveshjes.
- Të sigurojë ushqimin për qentë endacakë.
- Të përcaktojë një fond për mjekimin e rasteve të sëmurë.
- Të sigurojë ruajtjen e strehzës.
- Realizon deratizimin, dezinfektimin dhe dezinfektimin e strehës çdo 3 mujor.
- Pastrimin e gropës septike nga Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime çdo 3 mujor.
- Siguron një grope për varrosjen e kadavrave, bazuar në specifikimet e Ligjit të Veterinarisë në fuqi.
- Pastrimin ditor dhe ruajtjen e higjienës dhe ushqyerjen me anë të dy punonjësve të shërbimeve.

- Sterilizimin, vaksinimin, matrikullimin, rekuperimin dhe rilëshimin e qenve të shëndetshëm.
- Futjen e strehëzës në hartën e atraksioneve turistike.
- Merr në konsideratë raportimet e shoqatës Animals Need Me, ndaj performancës së punonjësve të pastrimit, dhe zgjidhjen e problematikave të parashtruara sipas legjislacionit në fuqi për punësimin.

NENI 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

NENI 7

Dispozita të fundit

- Kjo marrëveshje hartohet në 3 (tre) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe.
- Çdo rregullim ose ndryshim në këtë marrëveshje bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.
- Palët pasi e lexuan marrëveshjen, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Bardh SPAHIA

Përfaqësuar me vendim delegimi

Zv/Kryetar

Z. Tonin DEDAJ



**PËR
SHOQATËN "ANIMALS NEED ME"**

Flamant HOXHA

Flamant Hoxha